



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 01/84  
Datë: 15.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 81 dhe 82 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/84


Datë: 15.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komiteti ndërministror për përzgjedhjen e projektit në pajtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në këtë përbërje:
  - 1.1. Gazmend Sylja, Zyra e Kryeministrit - kryesues i Komitetit;
  - 1.2. Bislim Zogaj, Drejtor i AMKMK-së - zëvendës kryesues i Komitetit;
  - 1.3. Samir Hoxha, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - anëtar;
  - 1.4. Zijadin Geci, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - anëtar;
  - 1.5. Lahudin Myrtaj, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit - anëtar;
  - 1.6. Mervan Rexhepi, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtar;
  - 1.7. Arben Pajaziti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - anëtar;
  - 1.8. Vjollca Aliu, Muzeu i Kosovës - anëtare;
  - 1.9. Arbër Kuçi, Instituti i Historisë - anëtar;
  - 1.10. Hysen Matoshi, Instituti Albanologjik - anëtar;
  - 1.11. Bekim Jashari, Komuna e Skënderajt - anëtar;
  - 1.12. Përfaqësuesi i Familjes Jashari;
  - 1.13. Shemsi Kelmendi, Përfaqësues i Shoqatës së Arkitektëve - anëtar;
  - 1.14. Hysni Gucati, Përfaqësues i OVL-së të UÇK-së - anëtar.
2. Në rast se për ndonjë arsye ndonjë anëtar i Komitetit nuk mund ta vazhdojë punën, institucioni që e ka deleguar atë e ruan të drejtën për ta plotësuar me një përfaqësues tjetër.
3. Komiteti ndërministror detyrat e tij i kryen në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.
4. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në bashkëpunim me institucionet tjera kompetente, obligohet për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/84  
Datë: 15.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/76 të datës 21.11.2018**

1. Përfundim nga paragrafi 1. i Vendimit bazë me Nr. 01/76 të datës 21.11.2018, bëjnë mallrat me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina që janë importuar deri me datë 21.11.2018 nën procedurat doganore me regjim pezullues (depo doganore, import të përkohshëm, përpunim nën kontroll doganor dhe përpunimi i brendshëm) me rastin e lëshimit në qarkullim të lirë.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/84  
Datë: 15.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projekt Kodi i Procedurës Penale.
2. Projekt Kodi nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/84  
Datë: 15.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE INSTITUCIONALE PËR**  
**TË DHËNA TË HAPURA**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Me qëllim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, Qeveria e Republikës së Kosovës themelon strukturat e nevojshme përgjegjëse për udhëheqjen dhe menaxhimin e iniciativës për hapjen e të dhënave.
2. Hapja e të dhënave forcon qeverisjen e mirë dhe rrit besimin e qytetarëve në institucionet publike si dhe përforcon detyrimin e Qeverisë për të respektuar sundimin e ligjit dhe siguron një bazë transparente dhe të përgjegjshme për të përmirësuar vendimmarrjen dhe për të rritur ofrimin e shërbimeve publike.

**Neni 2**  
**Obligimi për Hapjen e të Dhënave**

1. Të gjitha ministritë dhe agjencitë në varësi të Qeverisë, obligohen të hapin të dhënat e tyre në përputhje me interesin publik dhe t'i publikojnë ato në portalin kombëtar për të dhëna të hapura, pa ndonjë pengesë ose kosto administrative.
2. Të gjitha ministritë dhe agjencitë në varësi të Qeverisë, obligohen të bashkëpunojnë me Ministrinë e Administratës Publike dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në publikimin e të dhënave në portalin kombëtar për të dhëna të hapura.
3. Hapja e të dhënave duhet të bëhet duke respektuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, si dhe Kartën për të Dhëna të Hapura e aprovuar nga Qeveria e Kosovës me vendimin nr. 07/87.

**Neni 3**  
**Inventari i të dhënave të hapura**

1. Të gjitha ministritë dhe agjencitë në varësi të Qeverisë, krijojnë dhe mirëmbajnë një inventar të të dhënave që prodhojnë. Inventari përkatës duhet të publikohet në ueb faqen e Ministrisë/Agjencisë dhe Portalin kombëtar për të dhëna të hapura.

2. Zyrtari përgjegjës i Ministrisë/Agjencisë për të dhënat e hapura përgatitë dhe mirëmban inventarin e të dhënave që prodhon institucioni. Inventari duhet të përmbajë titullin e dokumentit përkatës, njësinë përgjegjëse që e prodhon atë, dhe të dhëna të tjera të nevojshme.

#### **Neni 4** **Publikimi i të dhënave**

1. Të dhënat e Qeverisë publikohen në portalin kombëtar për të dhëna të hapura që menaxhohet nga ASHI.
2. Të dhënat publikohen në format që është i lexueshëm për kompjuterët (Excel, CSV).
3. Të gjitha të dhënat e publikuara në portalin kombëtar për të dhëna të hapura publikohen sipas licencës *Creative Commons Attribution 4.0 International (CC BY 4.0)*.

#### **Neni 5** **Përgjegjësitë institucionale**

1. Ministria e Administratës Publike (MAP) udhëheqë iniciativën e Qeverisë për hapjen e të dhënave. MAP menaxhon dhe koordinon të gjitha veprimet e nevojshme për hapjen e të dhënave. Institucionet e Republikës së Kosovës, bashkëpunojnë me MAP-in në hapjen e të dhënave dhe publikimin e tyre në portalin kombëtar për të dhëna të hapura.
2. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) është përgjegjëse të menaxhojë të gjithë procesin e iniciativës për të dhëna të hapura. Drejtori i Përgjithshëm i ASHI është Koordinator për Hapjen e të Dhënave. ASHI është përgjegjëse të mirëmbajë portalin kombëtar për të dhëna të hapura ([opendata.rks-gov.net](http://opendata.rks-gov.net)).
3. Në kuadër të ASHI-së të krijohet një njësi e veçantë që do të jetë përgjegjëse për koordinimin teknik të hapjes së të dhënave nga institucionet e Kosovës dhe të mirëmbajë portalin kombëtar për të dhëna të hapura.
4. Në kuadër të portalit kombëtar për të dhëna të hapura, secilës Ministri dhe Agjenci i krijohet një dritare/hapësirë e veçantë për të publikuar të dhëna në mënyrë të pavarur dhe të vazhdueshme.
5. ASHI përgatitë raporte çdo tre muaj për Grupin Drejtues dhe Ministrin e Administratës Publike, lidhur me progresin dhe gjendjen e përgjithshme të iniciativës për të dhëna të hapura.

#### **Neni 6** **Grupi Drejtues për të Dhëna të Hapura**

1. Themelohet Grupi Drejtues për të Dhëna të Hapura në këtë përbërje:
  - 1.1 Ministri i Administratës Publike, kryesues;
  - 1.2 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike, zëvendës kryesues;
  - 1.3 Drejtori Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike/Ministria e Administratës Publike, anëtar;
  - 1.4 Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, anëtar;
  - 1.5 Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, anëtar;
  - 1.6 Drejtori i Zyrës për Komunikim me Publikun /Zyra e Kryeministrit, anëtar;
  - 1.7 Përfaqësues nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, anëtar;
  - 1.8 Përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
  - 1.9 Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
  - 1.10 Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
  - 1.11 Përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
  - 1.12 Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, anëtar;
  - 1.13 Përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
  - 1.14 Përfaqësues nga Shoqëria Civile (katër përfaqësues).

2. Përfaqësuesit nga ministritë në Grupin Drejtues duhet të jenë në nivel të Zëvendësministrave, Sekretarit të Përgjithshëm ose Këshilltarit të Lartë Politik të Ministrit.
3. Agjencia për Shoqërinë e Informacionit është Sekretariati i Grupit Drejtues dhe në këtë rol ndihmon Kryesuesin në organizimin e takimeve të rregullta të Grupit Drejtues dhe përgatitë konkluzionet e takimeve dhe koordinon zbatimin e tyre.
4. Grupi Drejtues ka këto përgjegjësi:
  - 4.1 Të udhëheq, mbikëqyr dhe koordinoj të gjitha çështjet që ndërlidhen me procesin e zbatimit të iniciativës për hapjen e të dhënave;
  - 4.2 Hartimin dhe aprovimin e Planit të Veprimit për Hapjen e të Dhënave;
  - 4.3 Shqyrton raportet tre mujore të përgatitura nga ASHI, për progresin dhe sfidat në hapjen e të dhënave. Në shqyrtimin e raporteve Grupi Drejtues nxjerr konkluzione të cilat janë të obligueshme për zbatim nga ana e ASHI-së dhe akterëve tjerë relevant;
  - 4.4 Angazhohet për të zgjidhur çështjet që pengojnë dhe/apo vështirësojnë progresin në hapjen e të dhënave.

#### Neni 7

##### Zyrtarët ndërlidhës për të dhëna të hapura

Secila ministri dhe agjenci e Qeverisë së Kosovës obligohet të caktoj një zyrtar ndërlidhës për të dhëna të hapura në kuadër të strukturave ekzistuese. Zyrtari përkatës do të jetë përgjegjës të koordinoj veprimet brenda institucionit të tij për hapjen e të dhënave, duke përfshi krijimin dhe mirëmbajtjen e inventarit të të dhënave, publikimin dhe përditësimin e të dhënave në kuadër të portalit. Të njëjtët zyrtarë do të jenë pikat zyrtare të kontaktit për ASHI-në dhe institucionet e tjera në lidhje me të dhënat e hapura. Zyrtarët përkatës caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e agjencive përkatëse.

#### Neni 8

##### Grupi i Punës i Qeverisë për të Dhëna të Hapura


1. Grupi i Punës për të Dhëna të Hapura ka këtë përbërje:
  - 1.1. Udhëheqësi i njësisë përgjegjëse në ASHI për të dhëna të hapura (kryesues i grupit);
  - 1.2. Zyrtarët ndërlidhës për të dhëna të hapura të caktuar sipas nenit 7 të këtij vendimi.
2. Grupi i Punës për të Dhëna të Hapura është përgjegjës të koordinojë zbatimin e planit të veprimit për të dhëna të hapura dhe takohet rregullisht nën organizimin e njësisë përkatëse të ASHI.

#### Neni 9

##### Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

##### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë